



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 550, datë 31.7.2019

P Ë R

**PROPOZIMIN KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
TË KANDIDATURËS PËR KOMISIONER PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33, të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të kandidaturës së z. Besnik Dervishi për Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN “PËR PROPOZIMIN KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË KANDIDATURËS PËR KOMISIONER PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33, të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, i propozohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë kandidatura e z. Besnik Dervishi për Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kandidatura e tij është përzgjedhur, pasi plotëson kriteret e kërkuara, të parashikuara në nenin 35, të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

Z. Dervishi ka përfunduar një mandat në funksionin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i zgjedhur me vendimin nr.52, datë 24.7.2014, të Kuvendit, “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Ai ka kontribuar në konsolidimin e punës së bërë në drejtim të së drejtës së informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, gjatë punës së tij si Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për periudhën 2014-2019.

Z. Dervishi ka një përvojë të gjatë pune dhe ka kryer një sërë detyrash të rëndësishme shtetërore, ku, ndër më kryesoret, janë: deputet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, në legjislaturën VI, ministër i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, në periudhën korrik 2002 - dhjetor 2003. Gjithashtu, z. Dervishi ka ushtruar edhe një sërë detyrash të tjera shtetërore, si: zëvendësministër i Ekonomisë, prefekt i Qarkut të Tiranës, drejtor i Drejtorisë Juridike, në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe atë të prefektit të qarkut të Vlorës. Në ushtrimin e këtyre detyrave ai ka dëshmuar integritet e përkushtim.

Përvoja e gjatë profesionale gjatë ushtrimit të funksioneve publike të përmendura më lart e bëjnë kandidaturën e z. Dervishi të përshtatshme për vijimin e drejtimit të institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në vijim, paraqitet për shqyrtim e miratim projektvendimi “Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të kandidaturës për Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

KËSHILLI I MINISTRAVE

RELACION SHPJEGUES

PËR

PËRZGJEDHJEN E KANDIDATURËS QË I PROPOZOHEM **KUVENDIT PËR KOMISIONER PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT** **DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Bazuar në nenin 33, të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale zgjidhet nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, për një mandat 5-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në detyrë u zgjodh me vendimin nr.52, datë 24.7.2014, të Kuvendit, “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Në përfundim të mandatit të tij, Këshilli i Ministrave nisi procedurën për për zgjedhjen e kandidaturës që i propozohet Kuvendit për funksionin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Më 12.7.2019, Këshilli i Ministrave shpalli thirrjen publike nëpërmjet së cilës ftoi të gjithë të interesuarit, që përmbushin kriteret për aplikim.

Njoftimi për aplikim u publikua në *web*-faqen zyrtare të Kryeministrit, në *link*-un e mëposhtëm:

<http://www.kryeministria.al/newsroom/n-j-o-f-t-i-m-p-e-r-a-p-l-i-k-i-m-4/>

Përmbajtja e njoftimit për aplikim u bazua në nenet 33 e 35, të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

Në përfundim të afatit për aplikim, numri i aplikimeve të mbërritura në adresë të Kryeministrit është 1 (një), administruar me nr.3799 prot., datë 18.7.2019. Aplikanti është z. Besnik Dervishi.

Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë, në Kryeministri, shqyrtoi nga pikëpamja formale dosjen e aplikimit dhe konstatoi se dosja është e plotë. Ajo përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me njoftimin për aplikim.

Aplikanti Besnik Dervishi ka mbajtur mandatin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, zgjedhur me vendimin nr.52, datë 24.7.2014, të Kuvendit, “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Z. Dervishi ka një përvojë të gjatë pune dhe ka kryer një sërë detyrash të rëndësishme shtetërore, ku, ndër më kryesoret, janë: deputet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, në legjislaturën VI, ministër i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, në periudhën korrik 2002 - dhjetor 2003. Gjithashtu, z. Dervishi ka ushtruar edhe një sërë detyrash të tjera shtetërore, si: zëvendësministër i Ekonomisë, prefekt i Qarkut të Tiranës, drejtor i Drejtorisë Juridike, në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe detyrën e prefektit të Qarkut të Vlorës.

Mbështetur në jetëshkrimin e z. Dervishi, kontributin e tij në konsolidimin e punës së bërë në drejtim të së drejtës së informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, gjatë punës së tij si Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për periudhën 2014-2019, Këshilli i Ministrave i propozon Kuvendit, kandidaturën e z. Besnik Dervishi për funksionin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Përvoja e gjatë profesionale gjatë ushtrimit të funksioneve publike të përmendura më lart e bëjnë kandidaturën e z. Dervishi të përshtatshme për vijimin e drejtimit të institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Bashkëlidhur ju përcjellim dokumentacionin e kandidaturës së propozuar, si më poshtë vijon:

- Kopje të letërnjoftimit;
- *Curriculum vitae*;
- Formulari i vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar;
- Formulari i aplikimit për informim në zbatim të ligjit nr.45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- 2 letra rekomandimi.

KËSHILLI I MINISTRAVE